



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2022

VENDIM

Nr. 70, datë 23.02.2022

**PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT TË PUNËS SË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË
ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE PËR VITIN 2021”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit të punës së Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për vitin 2021”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

**RAPORT I PUNËS SË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE PËR VITIN 2021**

DREJTUAR : MBLEDHJES PLENARE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	4
II. RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT	5
A. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE	5
B. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE TË GJYQTARËVE DHE INTITUCIONEVE DHE HARTIMIN E AKTEVE ADMINISTRATIVE INDIVIDUALE.....	8
C. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT NË LIDHJE ME PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE	9
1. <i>Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve</i>	9
2. <i>Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve</i>	11
D. ÇËSHTJE TË TJERA	16
E. REKOMANDIME.....	

I. HYRJE

Raporti vjetor i punës së KVEVP hartohet në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 62, pika 16 të të cilit parashikohet se: *“16. Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit”*.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (në vijim KVEVP) është një ndër katër Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Aktualisht në përbërje të këtij Komisioni janë anëtarët : znj.Brikena Ukperaj (Lubonja), znj.Irena Plaku, z.Erjon Muharremaj dhe anëtarë zëvendësues znj.Fatmira Luli dhe z. Ridvan Hado.

Gjatë vitit 2021 Komisioni ka pasur në përbërje të tij anëtarët znj.Brikena Ukperaj (Lubonja), znj.Brunilda Kadi, z.Erjon Muharremaj dhe anëtarë zëvendësues znj.Fatmira Luli dhe z.Medi Bici. Ky Komisionin ushtron funksionet sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky Komision është asistuar përgjatë vitit 2021, nga tre këshilltaret ligjore znj.Alsma Shehu, znj.Rezarta Taushani dhe znj. Rudina Palloj, për të cilët vlerësimi i punës nga Komisioni është maksimal

Gjatë vitit 2021, Komisioni ka organizuar punën me qëllim përmbushjen e funksioneve, duke zhvilluar veprimtarinë e tij në disa drejtime, si më poshtë :

- Hartimin, diskutimin dhe paraqitjen për miratim të akteve nënligjore normative që përfshijnë fushën e veprimtarisë së KVEVP, siç është rasti i plotësimit me akte nënligjore i Skemës së Vlerësimit Etik dhe Profesional, përcaktimi i standardeve të sjelljes dhe normave të etikës së gjyqtarëve (Kodi i Etikës Gjyqësore), apo atyre që lidhen me rregullat standarde për efikasitetin e drejtësisë, në drejtim të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave ;
- Trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve drejtuar Këshillit për çështje që janë në fushën e veprimtarisë së KVEVP dhe paraqitjen e tyre pranë Këshillit për vendimmarrje;
- Administrimin e kërkesave të gjyqtarëve për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit dhe raportimin vjetor lidhur me këto veprimtari;
- Trajtimin e vazhdueshëm të dokumentacionit dhe praktikave të kaluara pranë Komisionit;
- Fillimin dhe zhvillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për periudhat e vlerësimit 2013-2016 (gradimin e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit

kalimtar), 2017-2019 dhe vlerësimin e përshpejtuar të detyruar, në rastet e konkurrencës të gjyqtarëve për ngritje në detyrë, duke iu dhënë përparësi këtyre të fundit.

II. RAPORTIM MBI VEPRIMTARIJË E KOMISIONIT

A. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE

Gjatë punës një vjeçare, Komisioni është angazhuar në procesin e hartimit, diskutimit dhe paraqitjes për miratim pranë Këshillit të një sërë aktesh nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:

1. Projektakti “Udhëzues për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave”, miratuar me vendimin nr.47, datë 11.02.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Hartimi dhe miratimi i këtij Udhëzuesi, konceptuar si një tërësi rregullash për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore, nëpërmjet tabelave standarde të unifikuara për të gjitha gjykatat, ka për qëllim të vendosë rregulla standarde për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave me qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e aktivitetit statistikor të gjykatave, duke synuar rritjen e performancës dhe efikasitetit të tyre. Në këtë kuadër, statistikave gjyqësore kanë për qëllim të shërbejnë si burime të dhënash dhe informacioni që mund të përdoren për menaxhimin eficient, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në aktivitetin e gjykatës. Ky udhëzues, i hartuar me mbështetjen dhe asistencën e vazhdueshme të ekspertëve të CEPEJ, është në përputhje me parimet dhe metodologjinë e vendosur në Udhëzimet e CEPEJ 2008 mbi Statistikat Gjyqësore (GOJUST) dhe me Udhëzimet e SATURN-it për menaxhimin e kohës gjyqësore të vitit 2015.

Veprimtaria e Komisionit në lidhje me sa më sipër, me mbështetjen e projektit të Këshillit të Europës SEJ III “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri”, projekt i cili ka ofruar asistencën teknike dhe ekspertizën ndërkombëtare lidhur me udhëzuesin, është angazhuar edhe në trajnimin e nëpunësve gjyqësorë civilë mbi bazën e çdo juridiksioni apeli, lidhur me metodologjinë e re të raportimit statistikor e përpunimin e të dhënave, në funksion jo vetëm të matjes së efikasitetit por edhe të ndërtimit të një politike mireadministruese nga secila gjykatë.

2. Projektakti “Kodi i Etikës Gjyqësore” miratuar me vendimin nr.171, datë 22.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky akt përmban standardet e etikës gjyqësore dhe rregullat e sjelljes të gjyqtarit, si një tërësi e parimeve, normave dhe rregullave të cilat udhëheqin sjelljen e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe veprimtarisë së tij jashtëgjyqësore. Kodi i Etikës synon të garantojë rritjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënien e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën, ligjin dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut. Kodi zbatohet nga të gjithë gjyqtarët e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, dhe për aq sa është e mundur edhe për nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykatat e shkallës së parë, të apelit dhe në Gjykatën e Lartë, për këshilltarët ligjorë në Gjykatën Lartë si dhe ndihmësit ligjorë në gjykatat e apelit.

Ky Kod reflekton një kontribut të përbashkët të KVEVP, Këshilltarit për Etikën si dhe partnerëve ndërkombëtare, në veçanti Projektit “Drejtësi për të Gjithë” të USAID, të cilët kanë ofruar ekspertizë të vlerësueshme në lidhje me çështje të teknikës legislative dhe po ashtu edhe qartësisë e koherencës së aktit me standardet ndërkombëtare.

3. Projektakti për miratimin e “Rregullave të vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë”, i miratuar me vendimin nr. 194, datë 12.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky akt ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për vlerësimin e ndihmësmagjistratëve që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Lartë, në përputhje me ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Këto rregulla janë hartuar për të plotësuar skemën e vlerësimit të gjyqtarëve të përcaktuar në ligj, duke respektuar parimet e pavarësisë, meritokracisë dhe zhvillimit të karrierës, efikasitetit, procesit të rregullt ligjor dhe konfidencialitetit parashikuar në nenin 69 të Ligjit për Statusin.

4. Projektakti “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, miratuar me vendimin nr.193, datë 12.05.2021

Në kuadër të plotësimit të kuadrit nënligjor të Skemës së Vlerësimit të gjyqtarëve “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, ka për qëllim shpjegimin e mënyrës se si përcaktohet niveli i vlerësimit të ndihmësmagjistratit, për secilin kriter të vlerësimit të përcaktuar nga ligji. Kjo metodologji është vlerësuar e nevojshme për të kryer një vlerësim sa më objektiv të ndihmësmagjistratit, i bazuar në një sistem pikësh, që caktohen mbi bazën e një analize të të dhënave të dala nga burimet e vlerësimit, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e tij. Në hartimin e metodologjisë janë mbajtur parasysh kriteret, burimet dhe nivelet e vlerësimit, të cilat janë të përcaktuara në ligjin 96/2016, për aq sa është e mundur të zbatohen, nisur nga natyra e ndryshme e punës së ndihmësmagjistratit, si dhe detyrat funksionale të tyre, sipas nenit 34 të Ligjit 98/2016.

5. Projektakti “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, miratuar me vendimin nr.195, datë 12.05.2021.

Hartimi dhe miratimi i këtij akti, pjesë e Skemës së Vlerësimit, ka për qëllim përcaktimin e rregullave të përzgjedhjes së çështjeve me short, procedurën e zhvillimit dhe dokumentimit të shortit për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim, në zbatim të nenit 91, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 194, datë 12.05.2021 “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë”.

6. Projektakti “Për miratimin e formës standarde të akteve të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, miratuar me vendimin nr.214, datë 26.05.2021.

Nëpërmjet këtij akti janë miratuar format standarde të tre akteve të vlerësimit në të cilët pasqyrohet respektivisht (i) vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit, (ii) mendimi i Kolegjit dhe (iii) mendimi i Kryetarit, të përcaktuara si burime vlerësimi në nenin 77, shkronja “ç” dhe “d” të “Ligjit për Statusin” dhe nenin 6, shkronja “ç”, “d” dhe “dh” të vendimit të KLGJ nr. 194, datë 12.05.2021 “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarit të komentuar në Gjykatën e Lartë”. Hartimi i këtyre formave standarde ka për qëllim (i) Përcaktimin e formatit mbi bazën e të cilit ndihmësmagjistrati bën vetëvlerësimin e tij, në referim të nenit 86 të “Ligjit për Statusin”; (ii) Përcaktimin e formatit mbi bazën e të cilit kryetari i Gjykatës së Lartë jep mendimin e tij, për efekt të vlerësimit të ndihmësmagjistratit, sipas parashikimeve të nenit 87 të “Ligjit për Statusin”; (iii) Përcaktimin e formatit mbi bazën e të cilit Kolegji pranë të cilit ndihmësmagjistrati ka ushtruar funksionin, jep mendim, për efekt të vlerësimit dhe (iv) Përcaktimin e standardeve të mendimit të Kolegjit dhe të Kryetarit në referim të parashikimeve të nenit 87, pika 1¹ të “Ligjit për Statusin”.

7. Projektakti “Për miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, miratuar me vendimin nr.215, datë 26.05.2021.

Ky akt, pjesë e Skemës së Vlerësimit, ka për qëllim miratimin e formës standarde dhe përmbajtjes së tabelave me të dhëna statistikore për ndihmësmagjistratët në Gjykatën e Lartë, duke iu referuar natyrës së veprimtarisë që ata kryejnë në Gjykatën e Lartë si dhe llojit të akteve që hartojnë në lidhje me trajtimin e çështjeve gjyqësore, referuar parashikimeve të Metodologjisë së Pikëzimit të miratuar, me qëllim marrjen e të dhënave burimore në lidhje me shpejtësinë dhe volumin e çështjeve të trajtuara nga ndihmësmagjistrati.

¹ Neni 87 pika 1 i Ligjit nr. 96/2016 parashikon se “Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, ku ushtron funksionin magjistrati që vlerësohet, paraqet mendim për veprimtarinë e magjistratit, në përputhje me standardet e vendosura nga Këshilli.”

B. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE TË GJYQATARËVE DHE INTITUCIONEVE DHE HARTIMIN E AKTEVE ADMINISTRATIVE INDIVIDUALE

Gjatë punës një vjeçare Komisioni ka trajtuar kërkesat e gjyqtarëve dhe/ose institucioneve përkatëse në lidhje me: kërkesat për leje të papaguar, ulje të ngarkesës në punë, përjashtim nga procedurat e shortit, etj. Këto kërkesa janë trajtuar nga Komisioni, i cili pasi ka zhvilluar procedurën administrative, në rastet kur trajtimi i tyre është vlerësuar se duhet të finalizohet nëpërmjet vendimmarrjes, ka përgatitur propozimet përkatëse për Mbledhjen Plenare. Konkretisht, gjatë vitit 2021, janë trajtuar dhe miratuar aktet administrative individuale si më poshtë:

1. Vendim nr. 100, datë 18.03.2021 “Për lehtësimin e ngarkesës së gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. Edlira Petri dhe z. Asim Vokshi”;
2. Vendim nr. 62, datë 16.02.2021 “Për ushtrimin e rekursit ndaj vendimit gjyqësor nr. 6 datë 26.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”;
3. Vendim nr. 116, datë 01.04.2021 “Për refuzimin e kërkesës për lehtësim të ngarkesës së gjyqtarës së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. Alma Kolgjoka”;
4. Vendim nr. 115, datë 01.04.2021 “Për refuzimin e kërkesës për lehtësim të ngarkesës së gjyqtarës së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. Esmeralda Xhili”;
5. Vendim nr. 114, datë 29.03.2021 “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtarës Evjeni Sinojmeri për zgjatjen me 1 (një) vit të afatit të lejes së papaguar”;
6. Vendim nr. 159, datë 14.04.2021 “ Për dhënie leje të papaguar gjyqtarës Gentiana Muçaj”;
7. Vendim nr. 160, datë 14.04.2021 “Për lehtësimin e ngarkesës së gjyqtarës së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. Manjola Xhaxho”;
8. Vendim nr. 188, datë 07.05.2021 “Për lehtësimin e ngarkesës së gjyqtarit të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, z. Gentian Medja”;
9. Vendim nr. 208, datë 20.05.2021 “Për dhënie leje të papaguar gjyqtarës Jeta Qinami”;
10. Vendim nr. 209, datë 20.05.2021 “Për dhënie leje prindërore gjyqtarës Ejona Lazellari”;
11. Vendim nr. 248, datë 09.06.2021 “Për dhënie leje të papaguar gjyqtarës Arta Llazari”;
12. Vendim nr. 386, datë 22.09.2021 “Për refuzimin e kërkesës për lehtësim të ngarkesës së gjyqtarit të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, z. Astrit Kalaja”;
13. Vendim nr. 438, datë 04.10.2021 “Për anulimin e vendimit nr. 6, datë 30.07.2021, të zëvendëskryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës”;
14. Vendim nr. 520, datë 03.11.2021 “Për uljen e ngarkesës së gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, znj. Klejda Çapja”;
15. Vendim nr. 575, datë 07.12.2021 “Për dhënie leje të papaguar gjyqtarës Zeta Tërpollari”;

16. Vendim nr. 595, datë 23.12.2021 “Për zgjatjen e afatit të lejes prindërore për gjyqtaren Ejona Lazellari”;
17. Vendim nr.293, datë 06.07.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e udhëzuesit standard të shtypit”;
18. Vendim nr. 292, datë 06.07.2021 “Për ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280. datë 10.12.2019, për caktimin e gjyqtarëve për mediat”;
19. Vendim nr. 424, datë 29.09.2021 “Për ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280. datë 10.12.2019, për caktimin e gjyqtarëve për mediat”.

Në kuadër të bashkëpunimit më Shkollën e Magjistraturës për realizimin e programit të formimit fillestar dhe vazhdues, janë trajtuar kërkesat e Shkollës, duke u miratuar me vendimet si më poshtë:

20. Vendim nr. 315, datë 22.07.2021 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të shkollës së magjistraturës, viti akademik 2021-2022”;
21. Vendim nr. 316, datë 22.07.2021 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021-2024”;
22. Vendim nr. 521, datë 03.11.2021 “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 315, datë 22.07.2021”;
23. Vendim nr. 97, datë 17.03.2021 “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën prill – korrik 2021”;
24. Vendim nr. 113, datë 29.03.2021 “Për një shtesë në vendimin nr. 97, datë 17.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në kuadër të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, KVEVP është angazhuar edhe në procesin e miratimit të programit të trajnimit vazhdues, duke propozuar tema konkrete për trajnim, në përputhje me nevojat që kanë rezultuar nga ecuria e vlerësimit etik dhe profesional, në përputhje me nenin 68 shkronja “ç” të Ligjit për Statusin.

C. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT NË LIDHJE ME PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE

1. Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në zbatim të nenit 171, pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ka administruar dosjet me aktet e vlerësimit profesional për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, përcjellë nga organet e rivlerësimit pranë Këshillit, pasi vendimet respektive për secilin gjyqtar kanë marrë formë të prerë.

a. Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradim) për periudhën e vlerësimit 2013-2016

Për të gjithë gjyqtarët për të cilët vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar ka marrë formë të prerë dhe janë përcjellë dosjet përkatëse pranë Këshillit, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimi), për 24/gjyqtarë me vendimet si më poshtë:

- 25. Vendim nr. 41, datë 04.02.2021** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 3 (tre) gjyqtarë;
- 26. Vendim nr. 75, datë 04.03.2021** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 6 (gjashtë) gjyqtarë;
- 27. Vendim nr. 163, datë 14.04.2021** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 3 (tre) gjyqtarë;
- 28. Vendim nr. 207, datë 20.05.2021** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 3 (tre) gjyqtarë;
- 29. Vendim nr. 259, datë 17.06.2021** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 3 (tre) gjyqtarë;
- 30. Vendim nr. 310, datë 16.07.2021** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 3 (tre) gjyqtarë;
- 31. Vendim nr. 437, datë 04.10.2021** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që

kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 3 (tre) gjyqtarë;

b. Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik

Lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas Programit të Vlerësimeve të vitit 2021, të miratuar me vendimin nr. 645, datë 23.12.2020, ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar etik dhe profesional për vitin e fundit të ushtrimit të detyrës, e cila përbën përparësi në procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve, për 4/gjyqtarë që kanë kandiduar për ngritje në detyrë dhe kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit, me vendimet si më poshtë:

32. Vendim nr. 42, datë 04.02.2021 “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 2 (dy) gjyqtarë;

33. Vendim nr. 237, datë 02.06.2021 “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë dhe që kanë ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 2 (dy) gjyqtarë;

c. Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019

Lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas Programit të Vlerësimeve të vitit 2021, të miratuar me vendimin nr. 645, datë 23.12.2020, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për 24/gjyqtarë, me vendimin si më poshtë:

34. Vendim nr. 177, datë 29.04.2021 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2021”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit për 24 (njëzetë e katër) gjyqtarë;

2. Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve

a. Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2013-2016

Për të gjithë gjyqtarët për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional sipas vendimeve të referuara më sipër si dhe procedurat e filluara në vitin paraardhës, procesi ka vijuar me hapat përkatës sipas parashikimeve të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore të Skemës së Vlerësimit, duke i dhënë përparësi gradimit dhe vlerësimit të përsheptuar të detyruar të gjyqtarëve që kanë kandiduar për ngritje në detyrë.

Gjatë vitit 2021, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektraportet e vlerësimit etik dhe profesional për **36 gjyqtarë për periudhën e vlerësimit 2013-2016**, të cilat janë miratuar me vendimet si më poshtë:

35. **Vendim nr. 5, datë 14.01.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Albana Boksi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
36. **Vendim nr. 7, datë 14.01.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Iliriana Olldashi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
37. **Vendim nr. 36, datë 28.01.2021.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Sandër Simoni, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
38. **Vendim nr. 48, datë 11.02.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Sokol Binaj, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
39. **Vendim nr. 52, datë 12.02.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Klodian Kurushi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
40. **Vendim nr. 67, datë 01.03.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Nertina Kosova, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
41. **Vendim nr. 93, datë 17.03.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Miliana Muça, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
42. **Vendim nr. 95, datë 17.03.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Daniela Shirka, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
43. **Vendim nr. 146, datë 08.04.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Saida Dollani, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
44. **Vendim nr. 144, datë 08.04.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Margarita Buhali, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
45. **Vendim nr. 136, datë 01.04.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Erjon Çela, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
46. **Vendim nr. 153, datë 14.04.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Klodiana Veizi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
47. **Vendim nr. 196, datë 12.05.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Sokol Ibi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
48. **Vendim nr. 202, datë 20.05.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Dhimitër Lara, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
49. **Vendim nr. 212, datë 26.05.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Enton Dhimitri, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
50. **Vendim nr. 244, datë 09.06.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Artur Kalaja, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;

51. **Vendim nr. 255, datë 17.06.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Asim Vokshi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
52. **Vendim nr. 264, datë 28.06.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Manjola Xhaxho, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”;
53. **Vendim nr. 271, datë 01.07.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Gentian Medja, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
54. **Vendim nr. 273, datë 01.07.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Igerta Hysi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
55. **Vendim nr. 297, datë 13.07.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Esmeralda Xhili, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
56. **Vendim nr. 359, datë 14.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Eriol Roshi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
57. **Vendim nr. 357, datë 14.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Emona Muçi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
58. **Vendim nr. 382, datë 22.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Elona Mihali, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
59. **Vendim nr. 397, datë 22.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Marsela Dervishi, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
60. **Vendim nr.384, datë 22.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Alma Ahmeti, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
61. **Vendim nr. 421, datë 29.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Arta Duka, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
62. **Vendim nr. 419, datë 29.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Sokol Pina, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
63. **Vendim nr. 515, datë 03.11.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Irida Kacerja, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”;
64. **Vendim nr. 526, datë 10.11.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Ornela Naqellari, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
65. **Vendim nr. 533, datë 17.11.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Rezarta Aliu, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
66. **Vendim nr. 541, datë 23.11.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Migena Laska, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
67. **Vendim nr. 559, datë 01.12.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Alma Kolgjoka, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
68. **Vendim nr. 553, datë 01.12.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Florjan Kalaja, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;
69. **Vendim nr. 554, datë 01.12.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Genti Dokollari, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;

70. Vendim nr. 577, datë 07.12.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Erjon Bani, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”;

b. Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit viti 2019.

Për të gjithë gjyqtarët për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, sipas vendimeve të referuara më sipër si dhe procedurat e filluara në vitin paraardhës, procesi ka vijuar me hapat përkatës sipas parashikimeve të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore të Skemës së Vlerësimit, duke i dhënë përparësi vlerësimit të përshpejtuar të detyruar të kandidatëve aplikues për ngritje në detyrë.

Gjatë vitit 2021, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektraportet e vlerësimit etik dhe profesional për **36 gjyqtarë**, të cilat janë miratuar me vendimet si më poshtë:

71. Vendim nr. 6, datë 14.01.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Albana Boksi, për vitin 2019”;

72. Vendim nr. 8, datë 14.01.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Iliriana Olldashi, për vitin 2019”;

73. Vendim nr. 37, datë 28.01.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Sandër Simoni, për vitin 2019”;

74. Vendim nr. 49, datë 11.02.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Sokol Binaj, për vitin 2019”;

75. Vendim nr. 65, datë 25.02.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Klodian Kurushi, për vitin 2019”;

76. Vendim nr. 68, datë 01.03.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Nertina Kosova, për vitin 2019”;

77. Vendim nr. 96, datë 17.03.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Daniela Shirka, për vitin 2019”;

78. Vendim nr. 94, datë 17.03.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Miliana Muça, për vitin 2019”;

79. Vendim nr. 137, datë 01.04.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Erjon Çela, për vitin 2019”;

80. Vendim nr. 145, datë 08.04.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Margarita Buhali, për vitin 2019”;

81. Vendim nr. 147, datë 08.04.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Saida Dollani, për vitin 2019”;

82. Vendim nr. 154, datë 14.04.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Klodiana Veizi, për vitin 2019”;

83. Vendim nr. 197, datë 12.05.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Sokol Ibi, për vitin 2019”;

- 84. Vendim nr. 203, datë 20.05.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Dhimitër Lara, për vitin 2019”;
- 85. Vendim nr. 213, datë 26.05.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Enton Dhimitri, për vitin 2019”;
- 86. Vendim nr. 243, datë 09.06.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Artur Kalaja, për vitin 2019”;
- 87. Vendim nr. 256, datë 17.06.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Asim Vokshi, për vitin 2019”;
- 88. Vendim nr. 265, datë 28.06.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Manjola Xhaxho, për vitin 2019”;
- 89. Vendim nr. 272, datë 01.07.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Gentian Medja, për vitin 2019”;
- 90. Vendim nr. 274, datë 01.07.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Igerta Hysi, për vitin 2019”;
- 91. Vendim nr. 298, datë 13.07.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Esmeralda Xhili, për vitin 2019”;
- 92. Vendim nr. 358, datë 14.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Emona Muçi, për vitin 2019”;
- 93. Vendim nr. 360, datë 14.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Eriol Roshi, për vitin 2019”;
- 94. Vendim nr. 385, datë 22.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Alma Ahmeti, për vitin 2019”;
- 95. Vendim nr. 383, datë 22.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Elona Mihali, për vitin 2019”;
- 96. Vendim nr. 398, datë 22.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Marsela Dervishi, për vitin 2019”;
- 97. Vendim nr. 419, datë 29.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Sokol Pina, për vitin 2019”;
- 98. Vendim nr. 422, datë 29.09.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Arta Duka, për vitin 2019”;
- 99. Vendim nr. 516, datë 03.11.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Irida Kacerja, për vitin 2019”;
- 100. Vendim nr. 527, datë 10.11.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Ornella Naqellari, për vitin 2019”;
- 101. Vendim nr. 534, datë 17.11.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Rezarta Aliu, për vitin 2019”;
- 102. Vendim nr. 542, datë 23.11.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Migena Laska, për vitin 2019”;
- 103. Vendim nr. 556, datë 01.12.2021** “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Erjon Bani, për vitin 2019”;

104. Vendim nr. 555, datë 01.12.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Genti Dokollari, për vitin 2019”;

105. Vendim nr. 560, datë 01.12.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Alma Kolgjoka, për vitin 2019”;

106. Vendim nr. 554, datë 01.12.2021 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit Florjan Kalaja, për vitin 2019”;

Gjatë vitit 2021, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektaktet për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurave të vlerësimit të përshpejtuar për **tre gjyqtarë**, për shkak të rënies së shkakut për fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, mbi bazën e të cilave janë miratuar vendimet si më poshtë:

107. Vendim nr. 349, datë 09.09.2021 “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren Luveda Dardha”.

108. Vendim nr.423, datë 29.09.2021 ”Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren Klodiana Gjyzari”.

109. Vendim nr.510, datë 25.10.2021 ”Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren Mariana Shegani”.

Në referim të parashikimeve të nenit 90 dhe 91 të Ligjit për Statusin dhe Programin e Vlerësimit për vitin 2021, KVEVP ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të përfshirë në program, duke i dhënë përparësi procesit të gradimit të gjyqtarëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe vlerësimit të kandidatëve të kualifikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Posaçme dhe Gjykatat e Apelit. **Në total janë miratuar në Mbledhje Plenare 72 raporte vlerësimi dhe janë deklaruar të mbyllura pa një vendim përfundimtar 3/procedura të tjera vlerësimi.**

Pavarësisht kompleksitetit, volumit të punës të procesit të vlerësimit etik dhe profesional dhe një sërë faktorësh që ndikojnë në ecurinë e tij, KVEVP së bashku me Njësinë e Vlerësimit është angazhuar maksimalisht në marrjen e masave për ecurinë dhe përfundimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për të cilët ka filluar tashme procedura e vlerësimit.

D. ÇËSHTJE TË TJERA

Komisioni ka trajtuar çdo kërkesë të paraqitur nga gjykatat, gjyqtarët dhe Institucione të tjera, që ka të bëjë me fushën e veprimtarisë së tij si dhe çdo çështje tjetër të adresuar pranë këtij Komisioni për trajtim, duke proceduar sipas rastit me përgatitjen e opinioneve ose kthimin e përgjigjeve përkatëse.

Disa nga çështjet e trajtuara janë si më poshtë:

- Administrimi i kërkesave për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit të gjyqtarëve, të cilat janë evidentuar në një regjistër elektronik të administruar pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- Trajtim i kërkesave të gjyqtarëve dhe institucioneve lidhur me çështje të cilat përfshihen në veprimtarinë e KVEVP apo kompetenca të tjera të Këshillit, për të cilat është hartuar kthim përgjigje apo adresuar për zgjidhje problematika e bërë prezent;
- Në kuadër të trajtimit të çështjeve të etikës, KVEVP gjatë vitit 2021 ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me Këshilltarin e Etikës si në hartimin e Kodit ashtu edhe në trajtimin e çështjeve të referuara që lidhen me etikën dhe rregullat e sjelljes së gjyqtarëve.

E. REKOMANDIME

Të vetëdijshëm për sfidat e KLGJ si organ qeverisës në përmbushje të detyrimit për një drejtësi cilësore dhe efikase, që nxit meritokracinë dhe profesionalizimin, KVEVP angazhohet të vazhdojë punën me përgjegjësi e përkushtim, duke rekomanduar:

1. Përfundimin e rregullave të detajuara për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit;
2. Përfundimin e akteve plotësuese të Skemës së Vlerësimit Etik dhe Profesional për gjyqtarët e komanduar në KLGJ (mbi asistencën teknike të dhënë më pare nga projekti Euralius V);
3. Vazhdimin e vlerësimit me prioritet të gjyqtarëve që aplikojnë për ngritje në detyrë;
4. Vazhdimin e procedurave të vlerësimit me qëllim gradimi për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;
5. Përfundimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për të gjithë gjyqtarët e përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2021;
6. Vijimin e punës duke kontribuar në përmirësimin e strukturës administrative të gjykatave dhe kushteve të punës së gjyqtarëve (asistencë teknike e projekti “Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura dhe përmirësimi i efikasitetit të Gjykatës së Lartë” zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje Perëndim, EWMI);
7. Vijimin e punës për plotësimin e rregullave të brendshme të gjykatave nëpërmjet unifikimit të regjistrave fizikë të dokumentimit të të dhënave të çështjeve gjyqësore (asistencë teknike e projektit SEJ III Këshilli i Europës);
8. Vijimin e punës për hartimin e një udhëzuesi për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve gjyqësore e monitorimin e shtyrjes së seancave gjyqësore (asistencë teknike e OSCE);

9. Vijimin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me nevojat për trajnimin e gjyqtarëve, përditësimin e listës së magjistratëve udhëheqes me qëllim rritjen e efektivitetit të procesit të mentorimit për kandidatët gjyqtarë;

Vazhdimin e bashkëpunimit me Komisionet e tjera për plotësimin e kuadrit nënligjor të nevojshëm, si brenda, ashtu edhe jashtë fushës së veprimtari